

VENDIM
Nr. 191, datë 9.3.2016

PËR KRIJIMIN E BAZËS SË TË DHËNAVE SHETËTËRORE PËR SISTEMIN E SHËRBIMEVE TË PUNËSIMIT

(Ndryshuar me Vendimin Nr. 11, datë 15.1.2026)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, dhe të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e bazës së të dhënave shtetërore për Drejtorinë Qendrore të Agjencisë Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive. Baza e të dhënave të SHKP-së quhet Sistemi i Shërbimeve të Punësimit (SSHP).

2. Sistemi i Shërbimeve të Punësimit (SSHP) përmban të dhëna për:

- a) punëkërkuesin;
- b) punëdhënësin;
- c) vende të lira pune.

3. Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive është administratori i vetëm i SSHP-së. AKPA-ja, në mbështetje të funksionimit të SSHP-së, krijon e administron platformën e bashkëpunimit “puna.gov.al”, ku realizohen procedurat e shërbimit të punësimit ndaj punëkërkuesve dhe punëdhënësve.

4. Të dhënat e SSHP-së mblidhen në kohë reale dhe kategorizohen në të dhëna parësore e dytësore.

5. Të dhënat parësore konsiderohen të dhënat, për:

a) Punëkërkuesit:

- i. punëkërkues i papunë;
- ii. punëkërkues i punësuar;
- iii. përfitues i shërbimeve të punësimit;
- iv. përfitues nga programe të nxitjes së punësimit;
- v. përfitues i kurseve të formimit profesional publik;
- vi. përfitues nga programi i pagesës së papunësisë.

b) punëdhënësit:

- i. shërbime që i ofrohen;
- ii. përfitues nga programet;
- c) vendet e lira të punës në sektorin privat.

6. Të dhënat dytësore konsiderohen të dhënat, për:

a) Punëkërkuesin:

i. të dhëna personale nga baza e të dhënave shtetërore të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile, administruar nga DPGJC-ja;

ii. të dhëna mbi punësimin nga baza e të dhënave shtetërore të tatimit elektronik, administruar nga DPT-ja;

iii. të dhëna nga trajtimi i tij me ndihmë ekonomike nga baza e të dhënave shtetërore të ndihmës ekonomike, administruar nga Shërbimi Social Shtetëror;

iv. të dhëna mbi leje drejtimi nga baza e të dhënave shtetërore të Regjistrit Kombëtar të Personave të Aftësuar për Drejtimin e Mjeteve, administruar nga DPSHTRR-ja;

v. të dhëna mbi kontributet e sigurimeve shoqërore nga baza e të dhënave shtetërore të sistemit elektronik për menaxhimin e kontributeve, administruar nga ISSH-ja.

b) Punëdhënësin:

i. të dhënat e subjektit tregtar nga baza e të dhënave shtetërore të Regjistrit Tregtar, administruar nga QKB-ja;

ii. të dhënat e subjektit të tatueshëm nga baza e të dhënave shtetërore të tatimit elektronik, administruar nga DPT-ja.

c) Vendet e lira të punës të shpallura nga punëdhënësit e sektorit shtetëror.

6/1. Në kuptim të këtij vendimi, në sektorin shtetëror përfshihen institucionet/entet dhe sistemet e administratës shtetërore, njësitë e fondeve speciale, ndërmarrjet shtetërore me kapital mbi 50 për qind shtetëror dhe shoqëritë aksionare shtetërore, që kanë detyrimin:

a) të publikojnë në platformën “puna.gov.al” të gjitha vendet e lira të punës, brenda një afati kohor jo më vonë se 7 (shtatë) ditë kalendarike përpara mbylljes së afatit për aplikim;

b) të raportojnë në platformën “puna.gov.al” të dhëna për numrin e aplikantëve dhe rezultatin përfundimtar të procesit të rekrutimit, brenda një afati jo më vonë se 7 (shtatë) ditë kalendarike nga përfundimi i procesit.

7. Dhënës të informacionit për SSHP-në janë punëdhënësit, punëkërkuessit dhe institucionet e tjera, me të cilat ai ndërvepron.

8. Baza e të dhënave të AKPA-së shkëmben informacion me institucione të sektorit shtetëror, sipas legjislacionit në fuqi për bazat e të dhënave shtetërore, lidhur me shërbimet që ofron. Bazuar në legjislacionin në fuqi:

a) institucionet, nga të cilat SSHP-ja merr të dhëna parësore, janë:

i. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile;

ii. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;

iii. Shërbimi Social Shtetëror;

iv. Qendra Kombëtare e Biznesit;

v. Instituti i Sigurimeve Shoqërore;

vi. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor;

vii. Departamenti i Administratës Publike.

b) institucionet, për të cilat SSHP-ja jep të dhëna parësore, janë:

- Shërbimi Social Shtetëror;

- Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor;

- Institucione të tjera publike, të cilat kanë interes të ndërveprojnë me SSHP-në.

8/1. Përpunimi i të dhënave personale në Sistemin e Shërbimeve të Punësimit (SSHP) kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Palët transmetojnë vetëm të dhënat personale të domosdoshme për realizimin e qëllimit të bazës së të dhënave në fushën e punësimit, duke zbatuar masat e duhura teknike dhe organizative për të siguruar një nivel të përshtatshëm sigurie.

9. Subjektet e interesuara (punëdhënës dhe punëkërkuess) kanë nivel aksesit për të hedhur dhe lexuar informacion të kufizuar, sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi, nëpërmjet sistemit të SSHP-së, si dhe shërbimit on-line. Për punonjësit e SHKP-së, niveli i aksesimit përcaktohet me rregullore të brendshme, sipas dispozitave ligjore.

10. Nivelet e aksesit të çdo përdoruesi janë:

a) nivel administrator;

b) nivel modifikues;

c) nivel lexues;

ç) nivel përdorues i jashtëm.

Rolet e nivelit të aksesit dhe të të drejtave të çdo përdoruesi përcaktohen në rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të bazës së të dhënave shtetërore për Sistemin e Shërbimeve të Punësimit”, që miratohet nga drejtori i përgjithshëm i AKPA-së.

11. Subjektet e interesuara janë punëkërkuessit dhe punëdhënësit.

12. Të gjitha ndryshimet në arkitekturën *software* dhe *hardware* dhe në strukturën e SSHP-së të Drejtorisë Qendrore të Agjencisë Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, të cilat mund të ndodhin në varësi të nevojave të institucionit dhe praktikave evropiane e ndërkombëtare në fushën e shërbimeve të punësimit, do të bëhen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

13. Ngarkohet Drejtoria Qendrore e Agjencisë Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Niko Peleshi